



# USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 42 (827846)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 20 tetor 2023

## Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Sporti i shërben më së miri forcimit të miqësisë mes FA-ve

Kampionati i Futbollit të Forcave të Armatosura, u zhvillua në mjedisin sportiv të Komandës së Forcës Tokësore. Ky kampionat shërbeu për rritjen e frymës së kolektivitetit dhe shpirtit të garës, tipare të cilat karakterizojnë Forcat tona të Armatosura për arritjen e synimeve dhe objektivave që ata i vënë vetes në realizimin e detyrës. Sfidat që i paraqiten ushtarakëve dhe FARSH-së, për përmbushjen e detyrave me përgatitje fizike të lartë, të motivuar, ndjejnë të lartë solidariteti dhe kondicion të mirë fizik, cilësi këto që personeli i FA-së, i tregoi më së

miri edhe në këtë aktivitet sportiv. Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e pranishme në këtë aktivitet mes të tjerash tha: "Kampionati i Futbollit në FA, harmonizon më së miri përfitimin e cilësive të forcës, rezistencës, shkathtësisë dhe shpejtësisë, aftësi që ushtaraku duhet t'i zotërojë për përballimin e stresit mendor dhe emocional në detyrë, stërvitje dhe operacion. Ky aktivitet tregoi që sporti i shërben më së miri forcimit të miqësisë midis ushtarakëve, rrit ndjenjën e bashkëpunimit, familjarizimin..."



»» faqe 2

## Ministri Peleshi: Rrugëtimi juaj është ai i sakrificës, vetëmohimit, ndaj ne do të investojmë ta mbajmë elitare këtë forcë



»» faqe 3

Gjeneral brigade Ferdinand Dimo, në Konferencën "Fuqia e Përbashkët Ajrore dhe Hapësinore" e mbajtur në Esen, Gjermani

Gjeneral brigade Ferdinand Dimo mori pjesë në Konferencën "Fuqia e Përbashkët Ajrore dhe Hapësinore" e mbajtur në Esen, Gjermani. Fokusi i kësaj konference ishte zhvillimi i parandalimit dhe mbrojtjes nëpërmjet fuqisë së përbashkët ajrore. Konferenca u hap me fjalimin e mirëseardhjes nga gjeneral Xhejms Heker, komandant i Forcës Ajrore për Europën dhe Afrikën, komandant i Komandës Ajrore Aleate si dhe drejtori i Qendrës së Kompetencës të Fuqisë së Përbashkët...



»» Faqe 2

Anijet turke "TCG Iskenderun" dhe "TCG Osmangazi" realizuan një vizitë portuale në Portin e Durrësit

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një vizitë kortezie në Komandën e Forcave Detare komandantin e Grupit të Anijeve turke, kapiten i rangut I Volkan Salih Eser, së bashku me komandantët e anijeve dhe atasheun ushtarak të Turqisë kolonel M. Kelami Kablay. Kundëradmiral Agastra i uroi mirëseardhjen dhe theksoi vlerësimin e vizitës portuale, si një angazhim i përbashkët për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Forcave Detare të...



»» Faqe 5

Forcat Speciale, heronjtë e heshtur të Forcave të Armatosura

Njësi speciale e Forcave të Armatosura nuk vepron vetëm në territorin shqiptar, por edhe në rajon, ajo është konsideruar nga NATO si njësi më elitare e Ushtrisë Shqiptare si dhe një nga njësitë më të mira të operacioneve speciale. Kjo njësi është e ngarkuar me operacione të posaçme në kohë lufte dhe para së gjithash me kundërterrorizmin në kohë paqeje. Për punën dhe përkushtimin e djemve dhe vajzave të kësaj njësie, që prej krijimit të saj dhe misionet në të cilat na kanë bërë krenar, për shtypin...



»» Faqe 6

# Gjeneral brigade Ferdinand Dimo, në Konferencën “Fuqia e Përbashkët Ajrore dhe Hapësinore” e mbajtur në Esen, Gjermani

Gjeneral brigade Ferdinand Dimo mori pjesë në Konferencën “Fuqia e Përbashkët Ajrore dhe Hapësinore” e mbajtur në Esen, Gjermani. Fokusi i kësaj konference ishte zhvillimi i parandalimit dhe mbrojtjes nëpërmjet fuqisë së përbashkët ajrore. Konferenca u hap me fjalimin e mirëseardhjes nga gjeneral Xhejms Heker, komandant i Forcës Ajrore për Europën dhe Afrikën, komandant i Komandës Ajrore Aleate si dhe drejtori i Qendrës së Kompetencës të Fuqisë së Përbashkët Ajrore i ndjekur nga fjala e admiralit Rob Bauer, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s. Në ditën e parë u diskutua rreth ndry-

shimeve aktuale të ambientit të sigurisë dhe si besueshmëria, kapacitetet dhe disponueshmëria e fuqisë ajrore dhe hapësinore, mund të ndikojnë në parandalimin dhe mbrojtjen në të gjitha fushat, shërbimet dhe kombet. Më pas u fol për sfidat e zhvillimit të gatishmërisë, disponueshmërisë dhe ngulmimit të fuqisë ajrore dhe hapësinore me qëllim përgatitjen për operacione me intensitet të lartë dhe shumë komplekse. Dita e dytë u hap me fjalën e gjeneralit James H. Dickinson, komandant i Komandës Hapësinore Amerikane. Më pas u vijua me diskutime në lidhje me zhvillimin në të ardhmen të kapac-

iteteve të fuqisë ajrore dhe hapësinore në mbështetje të mbrojtjes së përbashkët me fokus mbi bashkëpunimin me teknologjinë dhe industrinë e së nesërme. Këtu u theksua rëndësia e logjistikës, kapaciteteve industriale për të furnizuar me armatim, pjesë këmbimi dhe municion si dhe zinxhirin funksional e mbështetës përtej kufijve kombëtarë në rast konflikti. Konferenca u mbyll me një vizitë tek stendat treguese të prodhimeve teknologjike të firmave më të mëdha të botës si “Lockheed Martin”, “Northrop Grumman”, “Boeing”, “Airbus” dhe “DIEHL”.



# Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Sporti i shërben më së miri forcimit të miqësisë mes FA-ve

**K**ampionati i Futbollit të Forcave të Armatosura, u zhvillua në mjedisin sportiv të Komandës së Forcës Tokësore.

Ky kampionat shërbeu për rritjen e frymës së kolektivitetit dhe shpirtit të garës, tipare të cilat karakterizojnë Forcat tona të Armatosura për arritjen e synimeve dhe objektivave që ata i vënë vetes në realizimin e detyrës.

Sfidat që i paraqiten ushtarakëve dhe FARSH-së, për përmbushjen e detyrave me përgatitje fizike të lartë, të motivuar, ndjejnë të lartë solidariteti dhe kondicion të mirë fizik, cilësi këto që personeli i FA-së, i tregoi më së miri edhe në këtë aktivitet sportiv.

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e pranishme në këtë aktivitet mes të tjerash tha: “Kampionati i Futbollit në FA, harmonizon më së miri përfitimin e cilësive të forcës, rezistencës, shkathësisë dhe shpejtësisë, aftësi që ushtaraku duhet t’i zotërojë për përballimin e stresit mendor dhe emocional në detyrë, stërvitje dhe operacion.

Ky aktivitet tregoi që sporti i shërben më së miri forcimit të miqësisë midis ushtarakëve, rrit ndjenjën e bashkëpunimit, familjarizimin, respektin reciprok etj.

Përgatitja fizike dhe gjendja e mirë shëndetësore formojnë bazat e gatishmërisë fizike, e cila është thelbësore në arritjen e niveleve të kërkuara të gatishmërisë luftarake si dhe ruan kondicionin fizik të tyre për përmbushjen me sukses të detyrave si në stërvitje edhe në gatishmëri e operacion.

Rezultatet e larta të arritura nga ekipet sportive pjesëmarrëse në kuadër të aktiviteteve sportive rajonale dhe ndërkombëtare tregojnë dhe flasin qartë për rritjen e nivelit të përgatitjes fizike dhe sportit në FA.

Duke përfutur nga rasti, dëshiroj të falënderoj të gjithë ushtarakët e FA-së që kanë kontribuar në organizimin dhe zhvillimin e këtij aktiviteti si dhe Drej-



torinë e Operacioneve dhe Stërvitjes në bashkëpunim me të gjitha Komandat e Forcave, ato mbështetëse dhe strukturat e tjera për masat e marra për realizimin me sukses të këtij aktiviteti sportiv.

Duke uruar efektivat dhe ekipin fitues shpreh bindjen se në vazhdimësi do të organizojmë edhe aktivitete të tjera sportive në rang kombëtar, FARSH dhe ato ndërkombëtare të CISM.”



**N**ë Repartin e Zall-Herrit u kremtua 25-vjetori i krijimit të Batalionit të Forcave Speciale, pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Të pranishëm në ceremoni ishin Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, njëherësh Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji.

Në fjalën e tij, ministri Peleshi vlerësoi arritjet e këtij Batalioni, që sipas tij tashmë është i mirë pajisur me mjete moderne dhe që mbart me vete eksperiencën në operacione ushtarake jo vetëm brenda vendit tonë, por edhe në misionet e NATO-s, BE-së e Kombeve të Bashkuara, jashtë vendit.

Teksa kujtoi një prej heronjve të kësaj force, Feti Voglin, z. Peleshi tha se: “Ky rrugëtim ka pasur shumë djersë, shumë mund, shumë sakrificë, por në thelb ka qëndruar dashuria juaj për atdheun, dashuria për flamurin, vetëmohimi. Ky është thelbi, që e ka bërë këtë batalion të jetë sot modern, i ndërveprueshëm dhe dinjitoz krahas aleatëve tanë të NATO-s”.

“Stërvitja më e madhe në Ballkan e Forcave Speciale “Strong Balkan 2023”, që do të organizohet në vendin tonë, është tregues i qartë i pjekurisë dhe arritjeve që ky batalion së bashku me kompanitë e tjera të regjimentit kanë arritur në vite. Ne jemi të vendosur që ta mbajmë elitare këtë forcë, të investojmë më tepër, ta bëjmë atë më atraktive, ta rritim në numër, të rritim shpërblimin jo vetëm material, por edhe atë moral, duke rritur prestigjin e saj”, - theksoi ministri Peleshi.

Duke sjellë në vëmendje situatën e krijuar në rajon e Evropë, ministri i Mbrojtjes u angazhua para efektivëve të Batalionit të Forcave Speciale për shtimin e numrit të këtyre forcave, ashtu sikundër edhe për rritjen e mbështetjes financiare dhe vijimin e modernizimit të FA-së.

Në fjalën e tij, presidenti i RSH-së Bajram Begaj tha se: “Ky batalion ishte përpjekja jonë e parë për t’u bërë aso kohe pjesë e Aleancës më të suksesshme ushtarake në botë dhe rezultoi me sukses”. Më tej ai shtoi: “Roli dhe kontributi i Forcave të Armatosura në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë është i një rëndësie të jashtëzakonshme. Prandaj investimi te ju, është investim direkt te siguria e vendit, tek e ardhmja jonë e përbashkët”.



## Ministri Peleshi: Rrugëtimi juaj është ai i sakrificës, vetëmohimit, ndaj ne do të investojmë ta mbajmë elitare këtë forcë



Studentët e ciklit të parë Bachelor, viti 2 Navigim dhe Komandim Detar në Akademinë e Forcave të Armatosura, zhvilluan metodat e (ECDI-s) të lundrimit elektronik në Portin e Durrësit.

# Anijet turke "TCG Iskenderun" dhe "TCG Osmangazi" realizuan një vizitë portuale në Portin e Durrësit

**K**omandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një vizitë kortezie në Komandën e Forcave Detare komandantin e Grupit të Anijeve turke, kapiten i rangut I Volkan Salih Eser, së bashku me komandantët e anijeve dhe atasheun ushtarak të Turqisë kolonel M. Kelami Kablay.

Kundëradmiral Agastra i uroi mirëseardhjen dhe theksoi vlerësimin e vizitës portuale, si një angazhim i përbashkët për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Forcave Detare të dy vendeve.

Kapiten i rangut I Volkan Salih Eser falënderoi për mikpritjen dhe angazhimin e Forcës Detare gjatë vizitës portuale dhe çmoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, duke theksuar se ky bashkëpunim është shumë i rëndësishëm për ndërveprimin ndërmjet forcave.

Gjatë qëndrimit të anijeve turke në ujërat tona u zhvilluan dhe disa stërvitje të përbashkëta ndërmjet anijeve të dy vendeve.



## Forca Detare mbështet Policinë e Kufirit dhe Migracionit në trajnim për operacione SAR

Gjatë një periudhe dyjavore një ekip trajnues i Forcës Detare me kërkesë të Policisë së Shtetit dhe me mbështetjen e projektit "EU4LEA" të BE-së, realizoi kursin: "Përdorimi i radarëve dhe lundrimi" me efektivë të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu në vazhdim u realizua kursi: "Operacione të kërkim - shpëtimit (SAR)". Gjatë zhvillimit të dy kurseve kryesisht u trajtuan tema teorike të gërshetuara dhe me praktikën e daljeve në det.

Gjatë zhvillimit të trajnimit praktik u realizua hedhja e të dhënave në radar, për zbulimin e koordinatave të objekteve detare. Gjithashtu gjatë zhvillimit të trajnimit praktik të kërkim - shpëtimit, kryesisht u praktikuan skemat e kërkimit, marrja e njeriut jashtë bordit, dhënie ndihme anijes me pasagjerë në rrezik, dhënia e ndihmës së parë me mjetet ujore të Policisë Kufitare.



## Përmbyllet me sukses stërvitja më e madhe e Forcës Detare, "Flotex 2023"

Stërvitja Flotex është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, e cila shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në reazhimin e misionit dhe detyrave të saj themelore.

E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Qëllimi i stërvitjes është rritja e ndërveprueshmërisë midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare, si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR).

Stërvitja u ndoq nga afër dhe nga komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra, i cili në përfundim të stërvitjes përshëndeti pjesëmarrësit për realizimin e sukses të stërvitjes si dhe përmbylljen e një sezoni turistik shumë të suksesshëm.



**P**irro Mani lindi më 14 prill të vitit 1932, në Korçë, aktor dhe regjisor i njohur i shumë filmave dhe teatrove shqiptarë.

Regjisor dhe pedagog i shkëlqyer, për 25 vjet punoi në Teatrin Kombëtar. Është një ndër nxënësit e shkollës Ushtarake “Skënderbej” që u bë i famshëm në fushën e artit. Studioi në Institutin Shtetëror të Artit Teatror, GITIS, në Moskë. Pas kthimit në atdhe u emërua regjisor i Teatrit “A. Z. Çajupi”, Korçë, të cilin e drejtoi me sukses për rreth tetë vjet. Që nga 1967 - 1992 ka qenë regjisor i Teatrit kombëtar, ku ka vënë me dhjetëra pjesë teatrale. Në karrierën e tij artistike numëron mbi 80 shfaqje. Është nderuar me shumë çmime si mjeshtër i regjisë e skenave masive, njohës i thellë i mizanskenës. Shfaqjet kulminante janë “Cuca e maleve”, “Fytyra e dytë”, “Arturo Ui”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Epoka para gjyqit”, “Nata e 12 -të”, “Prometeu”, etj.

Është angazhuar edhe në mjaft filma artistikë. Ka fituar shumë çmime dhe është nderuar me titullin e lartë “Artist i popullit”. Mbetet brilant në disa role (aktor) si në “Loin des barbares”, 1994, Luan Kodra, “I teti në bronz” (1970), Sali Protopapa, “Vitet e para” (1965), Stavri Lara, etj....

...Historia e rrugës së artit për Pirro Manin, ka qenë histori suksesi, por dhe peripecish e vuajtjesh të shumta... Pirro Manin e kish puthur fati në ballë, se në laboratorët e teatrit korçar pati nën urdhrat e tij regjisorialë aktorë të klasit të parë, si Pandi Raidhi, bashkëshortët Dhorkë dhe Dhimitër Orgocka, Thimi Filipin, Stavri Shkurtin e të tjerë.

Së bashku, ata realizuan atje vepra me vlera të qëndrueshme e që lanë mbresa në kujtesën e artdashësit, si: “Hijet e Natës” të V. Kokonës, apo që dëshmuar art të shquar regjisorial dhe aktorial, edhe pse të ngopura me politizime, si “Kënetë” e Fatmir Gjatës, që fituan pëlqimin e autoriteteve. Haraçe si kjo e fundit, bënë të mundur që në skenën e Korçës t’u hapë dera mysafirëve të përrjetshëm: Shekspirit, Molerit, Bernard Shout, Ostrovskit...

Sukseset e ndritshme të farkëtuara në kudhrën e Korçës, e sollën Pirro Manin në teatrin qendror të vendit dhe i hapën atij horizonte më të gjëra e mundësi më të mëdha, por historia tamam në ato vite, solli krizat më të mprehta e dramit më të mëdha shoqërore, që si për të përqeshur artin e skenës, nuk do të ngjiteshin dot kurrë mbi një skenë teatri...

Ai kërkoi e gjeti vepra që e bënë atë regjisorin më të mirë të teatrit shqiptar. Ai realizoi “Cucën e Maleve”, “Fytyrën e Dytë”, “I pazëvendësueshmi”, “Epoka para Gjyqit”, “Shënomëni dhe Mua”, “Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur”, që ofronin hapësira të bollshme të frymëzonin regjisorin dhe interpretët, të kënaqnin dhe spektatorët e lozhës dhe ata të platesë.

Regjisor i famshëm ndërroi jetë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku vitet e fundit të jetës i kaloi me familjen e tij. Ai kurrë nuk hoqi dorë nga teatri, nga skena.

Ja çfarë pohon Pirro Mani në një intervistë, duke kujtuar me nostalgji rrugën e gjatë të tij në fushën e artit, kolegët e bashkëpunëtorët: “Gorçakovi, pedagogu im, ka qenë dishepull i Stanislavskit. I tillë ka qenë dhe Zavadski, udhëheqësi artistik i Kujtimit (Spahivogli). Ishte shumë e vlefshme praktika jonë në teatrin dhe shkollën ruse, pasi shihnim se si artistë të shquar iu përshtateshin kushteve. Edhe në binarët e hekurit stalinistë, ata arritën të realizojnë një pjesë të ambicieve të tyre artistike... Diktatura, e di që një pjesë teatrale me ide të papëlqyeshme



# Pirro Mani, skënderbegasi që i dha jetë artit shqiptar



për të, është mijëra herë më e rrezikshme se një vepër letrare heretike... Shumë veta e kanë kollaj t’i venë kryqin teatrit tonë të asaj kohe. Duhet të matesh mirë që të analizosh drejt kulmet e pakta, por të matesh edhe për shtrembërimin e tij, degradimin dhe përdhunimin e tij... Një nga shfaqjet më të bukura të mia, unë mbaj ‘Rrethimin e Bardhë’ të Naum Priftit, që e rrëzoi vetë Enver Hoxha, në një nga vizitat e tij në Korçë. Fabula ishte mbi rezistencën njerëzore në kushtet e rrethimit nga dëborat dhe mendohej se do të kalonte me pasaportën e temës së rrethimit kapitalist-revizionist. Unë u dashurova pas veprës. Sapo kisha ardhur nga Moska, ku destalinizimi po shkrinte çdo lloj akulli. Në tërë katet e Universitetit “Lomonosov” kërciste rock&roll-i nga gëzimi i hapjes së horizonteve. Kurse këtu... Unë arrita që tërë këtë përjetim ta plazmoja në atë dramë. I madhi e kapi menjëherë nostalgjinë time dhe e fundosi atë spektakël aq të ndjerë... Sinqerisht, ka qenë një nga punët më të bukura që kam bërë... Kam pasur fatin e madh të punoj me skenografë të jashtëzakonshëm si Agim Zajmi, Shaban Hysa, Ksenofon Diloja. Bashkëjetesa me ta më ndihmoi mjaft që të përvetësoja më mirë ligjet e arkitekturës skenike dhe më mprehu kërkesat”.

I madhi Pirro Mani u nda nga jeta duke lënë për artdashësin shqiptar vepra të cilat u kanë bërë sfidë kohërave me realitetin e tyre.



# Forcat Speciale, heronjtë e heshtur të Forcave të Armatosura



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

Njësia speciale e Forcave të Armatosura nuk vepron vetëm në territorin shqiptar, por edhe në rajon, ajo është konsideruar nga NATO si njësia më elitare e Ushtrisë Shqiptare si dhe një nga njësitë më të mira të operacioneve speciale. Kjo njësi është e ngarkuar me operacione të posaçme në kohë lufte dhe para së gjithash me kundër-terrorizmin në kohë paqeje. Për punën dhe përkushtimin e djemve dhe vajzave të kësaj njësie, që prej krijimit të saj dhe misionet në të cilat na kanë bërë krenar, për shtypin ushtarak, në këtë 25-vjetor, komandanti i Batalionit të Forcave Speciale, nënkolonel Bledar Lama sjell punën, sakrificën dhe përkushtimin deri në vetëmohim të kësaj njësie speciale.

Nënkolonel Lama, me kontribut të çmuar në këtë njësi elitë të Forcave të Armatosura, në këtë rrugëtim ka ushruar dhe detyra të rëndësishme si: Zv/Komandant i Batalionit të Forcave Speciale; Shef Shtabi në Batalionin e Forcave Speciale; Komandant në Kompaninë e Parë të Batalionit të Forcave Speciale; Negociator dhe Psikolog në shtabin e Batalionit të Forcave Speciale; Specialist për Përpunimin e Informacionit në shtabin e Batalionit të Forcave Speciale; Specialist për Stërvitjen në shtabin e Batalionit të Forcave Speciale; Komandant Grupi në trupën e batalionit të Forcave; Komandant Kontingjenti në mision e KFOR-it, Pejë, Kosovë; Specialist Zbulimi në Shtabin e Kontingjentit "Eagle 3" (Mision Luftarak Eagle) Kandahar, Afganistan; Specialist Zbulimi në Shtabin e Kontingjentit "Eagle 6", (Mision Luftarak "Eagle") Kandahar, Afganistan; Komandant grupi në Misionin "Liria Irakut", Mosul, Irak.

## Kur është krijuar Batalioni i Operacioneve Speciale?

Batalioni i Forcave Speciale është krijuar me Vendim të Këshillit të Mbrojtjes nr.2, datë 16 tetor 1998. Qëllimi kryesor i krijimit të kësaj njësie ishte që të krijohet një forcë elitë e kombit që të përballonte turbulencat politike, ekonomike e ushtarake që po kalonte vendi pas viteve '90, siç ishte rasti i pa precedentë i sulmit të organizuar ndaj repartit të Pëshkëpisë, ku humbën jetën disa ushtarakë, apo ngjarjet e 97-ës, ku destabilizuan vendin.

Kjo njësi u krijua pikërisht me qëllimin e vetëm të kalonte vijën e operacioneve klasike konvencionale, duke patur në gjirin e saj operatorë specialë të aftë të vepronin me grupe të vogla në fshehtësi të plotë por me efekt të madh për interesat e vendit. Kjo njësi do të operonte brenda dhe jashtë vendit në luftën kundër terrorizmit dhe formave të tjera të kërcënimeve kur lypset nevoja dhe të përdorej si aset i rëndësishëm i FA-së për të kryer detyra direkte, zbulim special apo asistencë ushtarake, gjë që forcat e tjera konvencionale nuk i përmbushnin dot.

## BOS, si u krijua njësia e operacioneve speciale në Ushtri?

Vendi i dislokimit të Forcave Speciale fillimisht ishte në rajonin e Farkës dhe momentalisht ndodhet i dislokuar Zall-Herr, Tiranë. Aktivitetin reparti e ka filluar më datë 24.02.1999 dhe ishte i përbërë nga Shtabi dhe 4 grupe speciale.

Komandanti i parë i Batalionit Special ka qenë kolonel Hysen Ymeri, një nga zbuluesit më të mirë të ushtrisë, i cili ka dhënë një kontribut mjaft të çmuar në ngritjen dhe zhvillimin e kësaj njësie.

Krijimi i Forcave Speciale u konsiderua i një rëndësie të veçantë, pasi për herë të parë Forcat tona të Armatosura kishin në gjirin e vet një njësi elitë e aftë të vepronte në tre dimensionet



Komandanti i Batalionit të Forcave Speciale,  
nënkolonel Bledar Lama

tokë-ajër-det për t'i paraprirë çdo lloj forme kërcënimi apo rreziku më një shpejtësi dhe aftësi të jashtëzakonshme.

## Cila është rëndësia e Forcave Speciale?

Rreziqet kombëtare po afirmohen gjithnjë e më shumë si modele asimetrike e hibride dhe se përballja ndaj tyre kërkon metoda të veçanta që kalon përtej koncepteve konvencionale. Të gjitha këto ndryshime në qasjen me sigurinë dhe format hibride që po përdorin vendet si Rusia kryesisht ndaj vendeve Baltike dhe Ballkanit perëndimor na dikton nevojën për të patur Forca Speciale të afta t'i përgjigjen në çdo kohë këtyre ndryshimeve. Mjedisi i sotëm strategjik karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga e panjohura dhe nga e paparashikuara. Skena e sigurisë botërore influencohet, përditë e më tepër nga shtete autokrate dhe organizata terroriste, të cilat po

arrijnë të krijojnë rreziqe e kërcënime për sigurinë e përgjithshme në mbarë botërore.

Konflikti i fundit mes Izraelit dhe organizatës terroriste të Hamas apo ai Rusi-Ukrainë kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e zhvillimit dhe integritetit të Forcave Speciale në këtë mjedis, duke përfshirë metodat, konceptet dhe teknologjitë e fundit të përdorura në këto luftime.

## Si është i organizuar ky batalion?

Forcat Speciale sipas doktrinës së NATO-s, SOF-së dhe kushteve e kërcënimeve në mjedisin e sigurisë rajonale e globale konsiderohen aset strategjike të një vendi.

Ato janë njësi të specializuara, të mirë organizuara, të mirë trajnuara dhe të kompletuara me personel të përzgjedhur në bazë të një trajnimit të gjatë taktik-psikologjik dhe të aftë për t'u përshtatur me metodat jo-konvencionale

në qasjen me objektivin. Këto operacione mund të kryhen në një spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional, të pavarura ose me forcat konvencionale, për të ndihmuar të arrijë gjendjen e dëshiruar. Batalioni special është i organizuar e strukturuar në bazë të reformimit të fundit të gjithë FA-së dhe është pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale, (ROS) duke pasur në organikë kompani të operacioneve speciale me drejtim tokë-ajër-det e aftë të planëzojë e zhvillojë operacione speciale me spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional. Batalioni special zotëron aftësi dhe kapacitetet e nevojshme të përmbushë me sukses tre detyra bazë që janë aksionet Direkt (AD), Asistencë ushtarake (AU) dhe Zbulim Special (ZS).

Batalioni Special zotëron teknologjinë e fundit të pajisjeve dhe modernizimit si mjete të shikimit



natën, shënjestër lazer për armët, kamera termale dhe mjete motorike ujore të gjeneratës së fundit që mundësojnë këtë njësi të përbushë të gjitha detyrat specifike që i ngarkohen.

Batalioni special është njësi unike në llojin e vet pasi operon në tre drejtimet si tok-ajër-det në një konceptim krejtësisht ndryshe nga kapacitetet konvencionale. Kjo nënkupton që batalioni special duhet të balancojë dhe modernizojë të gjitha këto kapacitete në të tre drejtimet. Por mbetet sfida akoma për t'u zhvilluar kapaciteti ajror, pasi në konceptet dhe doktrinën e NATO-s SOF-së, çdo njësi e Forcave Speciale duhet të zotërojë asetet e veta ajrore të dedikuara për operacionet speciale. Kjo njësi aktualisht nuk i ka në dispozicion kapacitetet ajrore por ka planifikuar t'i ketë në të ardhmen e afërt. Por, gjithsesi ky kapacitet mund të ofrohet edhe nga vendet aleate nëse kërkon nevojë për t'u dislokuar në komandat e SOCC-së të operacioneve speciale. Gjithashtu në rekomandimet e komandës së SOFCOM në NATO SHAPE apo në doktrinën bazë të SOF si AJP3.5, Forcat Speciale duhet të kenë komandim-kontroll të shkurtër dhe të qartë në mënyrë që të sigurohet pavarësia dhe të mos dekonspirohet operacioni. Pra rekomandohet që varësia e Forcave speciale të jetë direkt nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Misionet e forcave speciale ndryshojnë nga ato klasike konvencionale nga metoda e qasjes me objektivin. Në mjedisin e sotëm të sigurisë po gjenerohen gjithnjë e më shumë metoda asimetrike të luftës dhe kjo situatë kërkon medoemos përdorimin e forcave speciale pasi misionet klasike konvencionale nuk mund të jenë efektive në këtë mjedis. Misionet e forcave speciale janë më pak të kushtueshme pasi vetëm një grup i vogël operatorësh mund të kryejnë detyra me efekt operacional-strategjik për vendin.

Konsideratat politiko-ushtarake mund të kërkojnë operacione klandestinë ose teknikat e fshehta dhe pranimin e një shkalle të lartë rreziku politik apo ushtarak që nuk mund të realizohet me operacione nga forcat konvencionale.

#### **Cilat janë karakteristikat dhe cilësitë që i bëjnë operacionet speciale të jenë unike?**

Operacionet speciale janë unike, sepse ofrojnë zgjidhje strategjike të problemeve ose i shërbejnë nivelit operacional dhe plotësimin të objektivave politike. Forcat speciale janë, nga natyra, bashkëpunuese dhe të gjithanshme.

Forcat speciale (FS) janë organizuar në mënyrë të tillë që të bashkëpunojnë me forcat ajrore, forcat detare dhe tokësore nga vendet kontribuuese të trupave (TCNs), që përbëjnë një direktivë speciale të veçantë për misionin dhe komandën e komponentëve të operacioneve (SOCC), me një staf të përbashkët për të planifikuar dhe drejtuar operacione speciale.

Forcat speciale të NATO-s konsiderohen asete strategjike për t'u përdorur dhe menaxhuar për arritjen e objektivave strategjike dhe në disa raste të zhvillojnë detyra në nivel operativ.

FS-të janë të organizuar përmes një SOCC që së bashku me komandat e komponentëve të forcave tokësore, ajrore dhe detare qëndron në gatishmëri për misionet të ardhshme.

Operacionet speciale zhvillohen në një zonë të përbashkët operacionesh (JOA) me forcat e tjera ajrore, tokësore dhe detare. Në këtë kontekst një komandanti të nivelit operativ i krijohet efekt i madh sinergjik me unitetin e komandës, integrim në nivel operacional të forcave dhe siguron mbështetje për forcat e tjera të NATO-s. Operacionet speciale zakonisht kryhen me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto operacione zhvillohen duke përdorur aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike. Operacionet speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale dhe mund të përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim të përbashkët ndërinstytucional si me forcat tona po ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë.

#### **Nga ndryshojnë misionet konvencionale nga ato speciale?**

Operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale për vetë shkallën e rrezikut politik, teknikat operacionale, mënyrat si bëhet qasja me objektivin, varësia nga inteligjenca e detajuar operacionale dhe përdorimi i faktorëve



indigjenë. Operacionet speciale janë unike në llojin e vet sepse varen shumë nga cilësitë, aftësitë taktike-fizike e psikologjike të operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin konvencional në një komandë të bashkuar operacionale. Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë, duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

Operacionet speciale karakterizohen nga disa parime si: Tempo e lartë operacionale, ku shpejtësia dhe objektivit janë të lidhura pazgjidhshmërisht, pasi mund të gjendesh nën presionin e kohës për neutralizimin apo eliminimin e objektivit të kërkuar. Forcat speciale duhen integruar që në gjenezën e një konflikti pasi janë të afta të ndihmojnë leadershipin ushtarak me këshilla operacionale e strategjike për të analizuar faktorët politik, ekonomik e ushtarak që ndikojnë në një konflikt.

Operacionet speciale zakonisht merren me forcën e rëndësës së kundërshtarit dhe si objektiva mund të jenë VIP-a civil ose ushtarak. Operacionet speciale udhëhiqen nga parimet si fleksibilitet, zhdërvjelltësia dhe përshtatshmëria në mjedisin operacional. Ato zakonisht kryhen

me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto operacione zhvillohen duke përdorur aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike.

Operacionet speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale, të cilat përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim ndërinstytucional si me forcat tona po ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë.

Operacionet speciale janë unike në llojin e vet sepse varen shumë nga cilësitë aftësitë taktike-fizike e psikologjike të operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin konvencional në një komandë të bashkuar operacionale. Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

#### **Disa prej operacioneve ku Forcat Speciale të ushtrisë shqiptare kanë qenë të pranishme?**

Që nga krijimi, Forcat Speciale kanë marrë pjesë në shumë operacione dhe misione të

ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Operacionet e para kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999. Gjatë kësaj kohe prej gjashtë muajsh grupet speciale të Batalionit Special kanë marrë pjesë aktive në monitorimin e kufirit. Në vitin 2001-2002 grupet Speciale të FS-së morën pjesë në bashkëveprim me forcat e policisë së Shtetit për vendosjen e Rendit Kushtetues dhe qetësisë publike në rrethin e Tropojës, duke kryer shumë shërbime Speciale.

Në vitin 2001 në kohën e konfliktit me armë kundër shqiptarëve të Maqedonisë katër grupe speciale kanë marrë pjesë në monitorimin e kufirit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, si dhe kanë kryer detyra të ndryshme zbulimi.

Në vitin 2003-2004 Batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në shumë misione, ku detyrat kryesore kanë qenë monitorimi i gjithë vijës bregdetare, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës, armëve në bashkëveprim me forcat e kundër-terrorit të Ministrisë së Brendshme, duke bërë të mundur realizimin me sukses të plotë të gjitha misionëve të ngarkuara. Por Forcat speciale kanë zhvilluar disa misione jashtë vendit si në Irak, Afganistan, Kosovë konkretisht: Në gusht të vitit 2002 deri në shtator të vitit 2004, batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në 4 misione paqeruajtëse në Kabul të Afganistanit nën komandën e ISAF.

Nga viti 2005 deri në vitin 2008 batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë me dy grupe speciale në operacionin "Liria e Irakut", Mosul, Irak.

Misionet e forcave speciale arritën kulmin e tyre me pjesëmarrjen në misionet luftarake "Eagle" nga viti 2010 deri në vitin 2014, duke zhvilluar gjithsej 8 misione luftarake.

#### **Misioni juaj në mbrojtje të jetës patjetër ka dhe 'koston' e vet, a kemi jetë të humbura, në emër të jetës?**

Me të gjitha angazhimet e suksesshme në misionet luftarake apo në ato të paqes, Batalioni Special ka patur edhe humbje jete, ku vlen të përmendet heroizmi i Kapiten Feti Voglit, i cili sakrifikoi gjithçka për paqen e sigurinë në botë. Vepra dhe lavdia e tij janë tashmë pjesë e pandarë e aktivitetit tonë të përditshëm si brenda dhe jashtë vendit, duke na shërbyer si frymëzim e krenari për të vijuar plotësimin e ëndrrës së tij për patur sa më shumë paqe e harmoni në botë.

Forcat speciale sot kanë një vizion të qartë për zhvillimin e rezistencës dhe qëndrueshmërisë kombëtare, duke qenë pararojë e ndryshimeve në mjedisin e sigurisë. Sulmet hibride me strategjitë e fshehura, miksimi i taktikave konvencionale me ato jo-konvencionale, sulmet kibernetike, dezinformimi, lufta psikologjike, na bënë të vetëdijshëm mbi rolin e forcave speciale në ngritjen e strategjive të rezistencës kombëtare, shumëzimin e forcave, forcimin e partneritetit publik-privat, komunikimin strategjik dhe qasjen gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Jemi të bindur dhe të përgatitur për të përbushur të gjitha detyrimet tona në kuadër të mbrojtjes së vlerave të padiskutueshme të aleancës sonë NATO, duke u përballur direkt me sfidat dhe kërcënimet asimetrike për të siguruar lirinë e prosperitetin e popujve tanë.





**GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:**  
EKSPERT PËR SK, RAJONIN & NATO,  
ZV/PRESIDENT I KËSHILLIT TË ATLANTIKUT

# "Izraeli, e drejta për mbijetesë dhe mbrojtjen e vlerave të qytetërimit!"

**K**am ndjekur me vëmendje të shtuar, sigurisht i "shokuar nga pasojat", por dhe "profesionalisht i zhgënjyer" nga dështimi i Inteligjencës dhe sistemit të mbrojtjes Izraelite, kur më 7 tetor 2023, Hamasi (i shpallur organizatë terroriste nga ShBA/BE) goditi me breshëri raketash qytetarë të pafajshëm të grumbulluar në festë publike.

Paraprakisht, nëpërmjet rrjeteve sociale por edhe miqve/kolegëve të fushës të sigurisë në Jeruzalem/Telaviv, kam shprehur dhimbjen njerëzore për mijëra "jo viktimat", por dëshmorët e luftës kundër terrorizmit barbar.

Ndërsa në këtë artikull, do përpiqem të hedh dritë me: konsideratat gjeopolitike rreth sulmit terrorist; (historinë e konfliktit dhe përpjekjeve për paqen në rajon) peshimin (edhe pse s'ka të krahasuar) të fuqisë ushtarake; rekomandime për rikthimin e bashkëjetesës paqësore, si dhe impakte dhe këshilla gjeopolitike për aktorët politikë të Tiranës dhe Prishtinës Zyrtare. Më konkretisht:

## Shtatë mësimet dhe 7 mesazhe strategjike nga akti terrorist i 7 tetorit 2023

*Së pari*, për të dy shtetet sovraane (R. Sh & Kosovë) të një Kombi nuk ka opsion të dytë, përveçse t'i bashkohej/t pa hezitim "flamurit të solidaritetit të mbarë botës së qytetëruar", duke dënuar pa hezitim frymëzuesit politik dhe autorët e akteve kriminale të Hamasit, të cilët duke goditur barbarisht mbi popullsinë e pafajshme izraelite, e skalitën 7 tetorin 2023 si një ndër aktet terroriste nga më çnjerëzoret në historinë moderne të njerëzimit.

Nga ana tjetër, më e pakta, i gjej qesharake që "opinionistë të vetë-prangosur nga sindroma e Stockholmit" i risjellin opinionit oscilacionet gjeopolitike të Enver Hoxhës: "Izraeli një kobure në duart e SHBA/UK...., një shtet i krijuar nga imperializmi dhe sionizmi reaksionar".

*Së dyti*, përtej emërimit patriotik-fetar (HAMAS = Lëvizja e Rezistencës Islamike) "terroristët e pa Fe" që çirren si monstra: "Allahu Eakbar ose Zoti është i madh" edhe pasi vrasin barbarisht qytetarë të grumbulluar në festë publike; kur u presin kokat fëmijëve të pafajshëm; kur marrin zvarrë pengje pleq/gjyshër, gra dhe vajza, apo edhe kur përdorin si barrikada (ç)njerëzore bashkëqytetarë nga Rripi i Gazës, kurrësesi nuk kanë të përbashkët me kuranin dhe as me vlerat e fesë Islame!

Në të kundërt, frymëzuesit që fshihen si minj në transhetë e Rripit të Gazës, e keqpërdorin fenë për axhendën e tyre politike dhe i diskreditojnë vlerat e besimit Islam, që në asnjë rrethanë nuk frymëzon vrasjet makabre. Në të kundërt, si besimet e tjera komplementare, edhe ai Islam mbjell paqe, tolerancë, mirëkuptim dhe bashkëjetesë paqësore, pavarësisht Fesë, etj.

*Së treti*, ende mbetet në kuadrin e teorive konspirative nëse ky akt ishte "klonuar nga Kremli në kokën e terroristëve të Hamasit", por është e sigurt, që ky akt-barbar, i shërben përpjekjeve të dëshpëruara të Rusisë "Putiniste", për të hapur një front të ri lufte krahas asaj në Ukrainë. Por do të dështojë, ashtu si në përpjekjen për ta tërhequr Kinën në luftë me Tajvanit; apo për ta frymëzuar Beograd-in deri në marrëzinë e "pushtimit ushtarak të veriut të Kosovës, e cila prej Marrëveshjes së Kumanovës (06/1999) mbetet ende nën përgjegjësinë e trupave të NATO-s/KFOR-it".

*Së katërti*, ashtu si 11 Shtatori 2001, edhe kjo ngjarje demonstroi jo vetëm "dështimin e frikshëm" të inteligjencës Izraelite, por 7 tetori 2023, konfirmoi gjithashtu se, "garancia 100% të mëvetësia e mbrojtjes strategjike si dhe imunitet 100% në luftën kundër terrorizmit nuk ka për të patur". Bashkë me këtë mësim, del domosdoshmëri kritike, për të bashkëpunuar në luftën me të keqen e përbashkët/terrorizmin.

*Së pesti*, në Kremlin, Iran, Korenë e Veriut, dhe gjithandej

(përfshi në Shqipëri) në mendjet e ndryshkura, duke u përpjekur t'i japin dimension fetar dhe "legjitimuar" aktit terrorist, që: "vret barbarisht apo ngre barrikada/pengje me trupa njerëzorë të pafajshëm", kanë vënë në sprovë, të drejtën sovraane dhe ndërkombëtare (artikulli 2 dhe 51 i kartës së OKB) të vendimmarrjes për (vetë) mbrojtjen me çdo çmim të integritetit territorial, të jetës së qytetarëve dhe përdorimin e fuqisë ushtarake të Izraelit deri në asgjësimin e autorëve, terroristëve të Hamasit.

*Së gjashti*, ndërsa përtej rrethanave specifike të Izraelit për mbijetesë, "ushtrimi i të drejtës së hakmarrjes shembullore ndaj terroristëve", vjen edhe si një sfidë dhe kampionë e përbotshme, pasi: "nëse terroristët e Hamasit, duke vlarë/therur fëmijë të pafajshëm apo duke përdorur si barrikada, pengje, pleq/gjyshër, vajza dhe gra, etj., akte çnjerëzore", do të gjuhëzojë Izraelin, nuk do krijonte kjo një precedent fatal për të hedhur në erë rregullat, sistemin e sigurisë dhe vlerat e qytetërimit?

Ndërsa, për këdo kalemxhi të mirë paguar, pyetja mbetet: "nëse Izraeli dorëzohet sot, dhe nesër në një akt të ngjashëm kështu do gjuhëzohej edhe Uashingtoni, Berlioni, Londra, Parisi dhe çdo vend demokratik ndaj terroristëve çfarë pasojash do të ketë mbi paqen, shoqërinë njerëzore, harmoninë fetare, bashkëjetesën paqësore?!"

Nga ky këndvështrim, pra, kur Izraelit nuk i mbetet opsion tjetër, "hakmarrjen shembullore ndaj organizatës terroriste të Hamasit", e gjej në të drejtën e mbijetesës si dhe kontribut për të mbrojtur vlerat e mbarë botës së qytetëruar!"

*Së shtati*, mbështetja diplomatike nga vendet demokratike si dhe prezenca e menjëhershme ushtarake e SHBA-së në rajon (e cila konfirmon "me vepra" mbështetjen pa kompromis të Izraelit në luftën me terrorizmin) është jo vetëm për shkak të një lobi të fortë në vendimmarrjet e Uashingtonit. Ndërsa kështu, marrëdhëniet SHBA-Izrael meritojnë edhe një koment shtesë: "shumica dërrmuese e 194



shteteve (përfshi Shqipërinë) e kanë vetëshpallur SHBA-në aleat strategjik, ndërsa Izraeli është ndër të vetmet shtete të konfirmuara zyrtarisht nga Uashingtoni si aleat Strategjik për mbrojtjen e interesave gjeopolitike të SHBA-ve në rajon!”

### Historia e konflikteve dhe e përpjekjeve për paqe

Përtej aktit terrorist të 7 Tetorit, konfliktet dhe përpjekjet për paqe në Rajon kanë një histori të gjatë dhe i kanë rrënjët në “Palestinën historike”, që përfshin Izraelin e sotëm, Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës.

Nga ana tjetër, konflikti edhe pse rrotullohet brenda “dimensionit fetar” mbetet një çështje e rrënjësor thellë dhe e shumanshme, që përfshin çështje të territorit, refugjatëve, sigurisë, identitetit dhe interesave kombëtare. Me këtë rast, sjellim në vëmendje disa nga ngjarjet me peshë nga fundi i shekullit të 19-të deri në fillimin e shekullit të 20-të:

Siç mund të dihet gjerësisht, në fund të shekullit të 19-të, komunitetet hebraike anëmbanë Europës u përballën me persekutim dhe diskriminim, ndërkohe lëvizja sioniste, e udhëhequr nga Theodor Herzl, u shfaq si projekt për krijimin e një atdheu hebre në Palestinë.

Pas Luftës së Parë Botërore (1947), Kombet e Bashkuara propozuan një plan paqe, i cili rekomandonte ndarjen e Palestinës në dy shtete, hebreje dhe arabe, me Jerusalemin si qytet ndërkombëtar. Ndërsa udhëheqësit hebrej e pranuan planin, udhëheqësit arabë e refuzuan kategorikisht. Më 14 maj 1948, David Ben-Gurion shpalli themelimin e Shtetit të Izraelit. Të gjitha shtetet arabe, duke përfshirë Egjiptin, Jordaninë, Sirinë dhe Irakun, e kundërshtuan dhe u përfshinë në Luftën e Parë Arabe-Izraelite.

(1950-1960): Në vitin 1956, Izraeli, së bashku me Britaninë dhe Francën, pushtuan Egjiptin gjatë krizës së Suezit por presioni ndërkombëtar dhe rrethanat e luftës së ftohtë, i detyroi të tërhiqeshin. Lufta gjashtë ditore (1967): Konflikti 6 ditor midis Izraelit dhe fqinjëve të tij arabë, përfshiu Egjiptin, Jordaninë dhe Sirinë, rezultoi me pushtimin nga Izraeli të Gadishullit Sinai, Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës.

Lufta e Yom Kipurit (1973): Egjipti dhe Siria filluan një sulm të befasishtë ndaj Izraelit gjatë festës hebreje të Yom Kipur, por Izraeli jo vetëm e zbrapsi sulmin, por mori edhe më shumë territore. Marrëveshjet e Camp David (1978): të ndërmjetësuara nga SHBA, i normalizuan marrëdhëniet midis Izraelit dhe Egjiptit, i cili u bë vendi i parë arab që njohu Izraelin.

(1987-1993): Protestat dhe kryengritjet palestineze kundër pushtimit izraelit në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës shënuan Intifadën e Parë. (1993): Negociatat sekrete të Marrëveshjet e Oslos, themeluan Autoritetin Palestinez dhe siguruan një kornizë për vetëqeverisjen në pjesë të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës.

Përpjekje të tjera, si Samiti i Camp David (2000), Samiti i Tabës (2001) dhe Konferencën e Annapolis (2007), nuk kanë arritur gjithsesi të prodhojnë ndonjë zgjidhje të qëndrueshme në rajon. Marrëveshjet e Abrahamit (2020): Izraeli normalizoi marrëdhëniet me Emiratat e Bashkuara Arabe, duke thyer qëndrimin tradicional arab për mosnjohjen e Izraelit pa një zgjidhje për çështjen palestineze.

Mbi kapacitetet/fuqinë ushtarake të Izraelit (FMI) dhe organizatës militante (terroriste) Hamas.

Fuqia ushtarake midis Izraelit dhe Hamasit, janë tërësisht të pakrahasueshme, pasi Izraeli është një shtet sovran me një ushtri të modernizuar, ndërsa Hamasi është vetëm një organizatë militare/ushtarake. Megjithatë:

Fuqia ushtarake e Izraelit: Ka një forcë të armatosur prej rreth 160-170 mijë forcë aktive (shërbim i detyrueshëm ushtarak) si dhe rreth 500 mijë forcë rezervistë. Forcat e Mbrojtjes së Izraelit (IDF) përbëhen nga forcat tokësore, forcat ajrore, forcat detare si dhe njësi të specializuara.

Ka një industri të avancuar të mbrojtjes dhe merr ndihma dhe mbështetje të konsiderueshme ushtarake nga SHBA. Posedon sisteme të avancuara të armëve, duke përfshirë: “Iron Dome”, një sistem anti-raketë i krijuar për të kapur dhe asgjësuar raketat dhe predhat e artilerisë si dhe sistemin “Arrow” që është një familje raketore anti-balistike; Avionë luftimi të avancuar, duke i dhënë Izraelit epërsi ajrore të pa konkurrueshme në rajon. Zotëron po ashtu Tanket Merkava të gjeneratës së fundit, që po i shohim edhe në shtetërrëhimin e shpallur mbas aktit terrorist të 7 tetorit.

Pavarësisht “dështimit” në këtë rast, Izraeli konsiderohet lider global për kapacitetet e Inteligjencës dhe sigurinë kibernetike, fushë që po bashkëpunon edhe RSH, Kosova dhe vendet e tjera të rajonit të Ballkan.

Fuqia ushtarake e Hamasit: Harakat al-Muqawama al-Islamiya (Lëvizja e Rezistencës Islamike), themeluar në 1987, organizatë

politike-ushtarake (e shpallur terroriste nga SHBA/BE) që kontrollojnë Rripin e Gazës, pjesë e territoreve Palestineze, ka prezencë edhe në West Bank.

Aftësitë ushtarake përbëhen kryesisht nga forca të parregullta të inkuadruara në Brigadat Izz ad-Din alQassam. Aktualisht, ka disa mijëra luftëtarë aktivë si dhe mund të rekrutojë një numër më të madh rezervistësh. Është i njohur për rrjetin e gjerë të tuneleve në Gaza, i cili përdoret për kontrabandë dhe sulme të befasishme, si dhe në sulmin terrorist të datës 7 Tetor 2023.

Zotëron kryesisht armë të lehta si automatikët dhe mitralozat që përdoren për luftën terroriste dhe guerile, ndërsa eksplozivët, raketat dhe mortajat që përdoren ndaj Izraelit si armë kryesore e shantazhit. Gjithsesi përtej befasisë dhe dështimit në rastin e 7 Tetorit, mbi 85 % e raketave të Hamasit janë kapur dhe asgjësuar nga sistemi i “Kupolës së Hekurt të Izraelit”.

Në përmbledhje, kursesi Hamasi nuk ka as tiparet, as strukturën e C2; as kapacitete dhe as aftësi për t’u krahasuar me fuqinë ushtarake të një kombi sovran si Izraeli. Për më tepër, Izraeli ka kapacitete dhe fuqi ushtarake jo vetëm për ta “mposhtur Hamasin” por për t’u përballur dhe dominuar të gjitha vendet Arabe së bashku.

IV. Parime dhe rekomandime për zgjidhjen e konfliktit dhe rikthimi te masat të ndërtimit paqes në rajon:

Paraprakisht më duhet të qartësoj fort se, për sa trajtoj në këtë opinion, kursesi nuk kanë të bëjnë me zgjidhje shteruese aq më pak paragjykimet mbi sovranitetin territorial, identitetet kombëtare, apo rrënjët e konflikteve mes Izraelit dhe vendeve Arabe. Gjithsesi, po paraqes disa rekomandime për situatën pas dhe përtej rastit të fundit:

Për situatën mbas 7 Tetorit: vendet në konflikt, komuniteti ndërkombëtar, NATO/BE etj., duhet ta dënojnë zyrtarisht dhe pa asnjë hezitim aktin terrorist të 7 Tetorit 2023, në vazhden e akteve kriminale të Hamasit që minojnë bashkëjetesën paqësore mes popujve në rajon dhe kërcënojnë balancat gjeopolitike dhe vlerat e qytetërimit.



PËRTEJ AKTIT TERRORIST TË 7 TETORIT, KONFLIKTET DHE PËRPJEKJET PËR PAQE NË RAJON KANË NJË HISTORI TË GJATË DHE I KANË RRËNJËT NË “PALESTINËN HISTORIKE”, QË PËRFSHIN IZRAELIN E SOTËM, BREGUN PERËNDIMOR DHE RRIPIIN E GAZËS. NGA ANA TJETËR, KONFLIKTI EDHE PSE RROTULLOHET BRENDA “DIMENSIONIT FETAR” MBETET NJË ÇËSHTJE E RRËNJËSOR THELLË DHE E SHUMANSHME, QË PËRFSHIN ÇËSHTJE TË TERRITORIT, REFUGJATËVE, SIGURISË, IDENTITETIT DHE INTERESAVE KOMBËTARE.

Për më tepër nuk ma lejon as grada e lartë ushtarake (gjeneral (R)) por as eksperiencia në NATO të bëj “moralizime populiste” mbi detyrimet kushtetuese ndaj Forcave të Armatosura të Izraelit për mbrojtjen e jetës së qytetarëve, si dhe aq më pak ta paragjykojë të drejtën që ka Izraeli të përdorë në mënyrë të përshkallëzuar fuqinë ushtarake (përfshi hakmarrjen shembullore për ta asgjësuar dhe shkukur nga rrënjët Hamasin), për të rivendosur gjendjen në terren si dhe besimin e qytetarëve Izraelit te standardet e sigurisë.

Ndërsa, frymëzuesit dhe terroristët duhet të çohen sa më shpejt të jetë e mundur para drejtësisë Izraelite dhe Gjykatës ndërkombëtare për krime kundër njerëzimit. Sigurisht duhet vetëpërmbytje dhe respektimi i konventave ndërkombëtare, duke përdorur armë me precizion të lartë kundër terroristëve, infrastrukturave dhe lidhjeve të Hamasit; duke hapur korridore humanitare dhe mjekësore për popullsinë civile si dhe duke shmangur në maksimumin e mundshëm viktima të pafajshme (megjithëse në masën 100 % është mision i pamundur).

Thënë këto, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk do të duhet të ndalen përpjekjet diplomatike nga Izraeli, vendet Arabe dhe komuniteti ndërkombëtar. Më tej për të krijuar frymën e mirëbesimit do të duhet një akt falje si dhe një marrëveshje paraprake me faktorët lokalë të moderuar që zgjidhjen e konfliktit dhe bashkëjetesën paqësore nuk e shohin kursesi nëpërmjet akteve terroriste.

Ndërsa përtej aktit terrorist të 7 Tetorit, situata në terren dhe historia e pas-konflikteve na mëson se rruga drejt paqes kërkon përkushtim, kompromis dhe përfshirje të të gjithë faktorëve relevant.

Edhe konflikti izraelit-arab është një çështje komplekse gjeopolitike e shtrirë në dekada dhe që përfshin një mori faktorësh historikë, fetarë, kulturorë, territorialë, identitetin kombëtar, interesa

ekonomike, etj. Prandaj, një zgjidhje e qëndrueshme përfshin adresimin e këtyre faktorëve dhe sigurisht do duhet të prevalojnë mekanizmat diplomatike mes Izraelit, Palestinës dhe vendeve të tjera.

Një opsion i diskutuar gjerësisht si zgjidhje është krijimi i dy shteteve sovraane, Izraelit dhe Palestinës, që do të përfshinte negociatat për kufijtë, refugjatët dhe Jerusalemin si kryeqytet i përbashkët për të dy vendet sovraane. Bashkë me këtë, adresimi i çështjes së refugjatëve palestinezë, përmes kompensimit, zhvendosjes ose kthimit sipas kushteve të dakordësuara paraprakisht.

Masat e mirëbesimit reciprok përfshijnë de-militarizimin, balancat e fuqisë ushtarake dhe garancitë e sigurisë për Izraelin, lirimimi i të burgosurve, bashkëpunimi ekonomik dhe shkëmbimet kulturore. Sigurisht, aktorët ndërkombëtarë, OKB, SHBA, BE si dhe ata rajonalë, kanë një rol thelbësor në suksesin e negociatave për paqe të qëndrueshme.

V. NË SHITESË, si në çdo dhjetëra vlerësime me peshë në fushën e sigurisë, dëshiroj që edhe këtë artikull ta përmyll me “impakte dhe rekomandime strategjike” për faktorët dhe aktorët në Tiranë dhe Prishtinën zyrtare:

Patjetër që gjej paralele dhe impakte mbi interesat mbarëkombëtare, pasi sulmi terrorist i Hamasit ndodhi jo rastësisht vetëm 2 javë mbas aktit terrorist, që bandat mercenare të frymëzuara nga oscilacionet e Ministrit të Millosheviçit dhe interesat e Rusisë “Putiniste”, ndërmorën ndaj Kosovës.

Gjithashtu dua ta përsëris se falë gjakut të dëshmorit të kombit Afrim Bunjaku dhe profesionalizmit elitari të FSK-së si dhe mbështetjes së aleatëve strategjikë (USA/NATO), Kosova fitoi një betejë historike: “duke shmangur një skenar të Krimesë për t’i kthyer manastiret e Kosovës në depo armësh, bunkerë terroristësh dhe barrrikada të civilëve të pafajshëm!”

Nuk mund të mos shpreh neverinë ndaj një përpjekjeje për të baraz(sh)vlerësuar përpjekjet e çlirimtarëve të Kosovës me ato të

grupit terrorist të Hamasit! Përtej “revoltës patriotike”, përgjigja është e vërteta, që: “në asnjë rast të vetëm nuk janë goditur popullsia e pafajshme; kurrë nuk janë marrë pengje femijë, pleq, gra apo vajza Serbe”. Përkundrazi, projekti i shenjtorit Rugova prevaloi dhe me ndërhyrjen legjitime të NATO-s Kosova u çlirua nga pushtuesit Serb.

Thënë këto, Tirana dhe Prishtina zyrtare do duhet të konfirmojnë solidaritetin dhe mbështetje të pakushtëzuar për Izraelin, jo vetëm për shkak të lidhjeve historike dhe reciprocitetit të mirënjohjes që ka Izraelit ndaj kombit tonë për shpëtimin e Hebrejeve nga nazistët gjatë Luftës II botërore, por edhe për t’u rreshtuar pa kompromis krahu SHBA-ve (aleatë strategjik të Izraelit) që kanë luajtur rol përcaktues jo vetëm për çlirimin dhe faktorizimin gjeopolitik të Kosovës, por edhe specifikisht për njohjen si “surprizë e mençur” në dhomën ovale (në kuadër të Projektit të Presidentit Trump) nga Izraeli në kuadër të paketës 12 miliard euro, përfshi autostradën e paqes, linjën hekurudhore, portin në ujërat e thella të Adriatikut, etj.

Ndërsa e risjellë në kontekstin e interesave gjeopolitike, kombi ynë ka arsye të forta ndërsa autoritetet shtetërore e kanë detyrim shtetëror jo vetëm të “vendosin numër telefoni për të ndihmuar bashkëqytetarët shqiptarë për transportin nga zonat e konfliktit” por dhe të dënojnë “me një zë të përbashkët” terrorizmin si dhe të mbështesin përpjekjet e Izraelit në këtë betejë me të keqen e përbashkët/terrorizmin.

Në përmyllje përsëris se “përtej luftës, paqja mbetet misioni i vështirë por opsioni i vetëm”. Kështu jam besimplotë se Izraeli jo vetëm do t’i ndëshkojë në mënyrë shembullore terroristët por paqja dhe vlerat e qytetërimit do të triumfojnë mbi terroristët e Hamasit, Rusinë “Putiniste”, Kim-Jong-un, Iranin dhe ndaj çdo mendje tjetër të deformuar në botë.

# Chatbot-i juaj miqësor i inteligjencës artificiale mund të dijë shumë për ju nga mënyra se si shkruani

Inteligjenca artificiale mund të hamendësojë me saktësi informacionin personal të një përdoruesi, si raca, gjinia, moshë dhe vendndodhja, bazuar në atë që shkruan, thotë një studim i ri.

Autorët e studimit thonë se AI-ja mund të përdoret për të arritur të dhëna personale në një shkallë të paarritshme më parë dhe të vendoset nga hakerat.

“Nuk është as e qartë se si e rregulloni këtë problem. Ky është shumë, shumë problematik”, - tha një nga autorët e studimit për “Wired”. Inteligjenca artificiale mund të hamendësojë me saktësi informacionin e ndjeshëm për një person bazuar në atë që ai shkruan në internet, sipas një studimi të ri nga studiuesit në “ETH Zurich”, që u botua në tetor. Ky informacion përfshin racën e një personi, gjininë, vendndodhjen, moshën, vendin e lindjes, punën dhe më shumë, attribute që zakonisht mbrohen nga rregulloret e privatësisë.

Autorët e studimit thonë se AI mund të konkludojë të dhëna personale në një shkallë të paarritshme më parë dhe mund të vendoset nga hakerat, duke përdorur pyetje, në dukje pa rrezikshmëri, për përdoruesit që nuk dyshojnë. Studimi shikoi se si modelet e mëdha të gjuhës, të cilat chatbot-i i fuqizon si ChatGPT, mund të nxiten të nxjerrin detaje personale rreth 520 profileve reale të përdoruesve të Reddit dhe postimeve të tyre nga viti 2012 deri në 2016. Studiuesit i analizuan manualisht këto profile dhe i krahasuan gjetjet e tyre me supozimet e AI-së.

“Vëzhgimi kryesor i punës sonë është se LLM-të më të mira janë pothuajse po aq të sakta sa njerëzit, ndërsa janë të paktën 100 herë më të shpejta dhe 240 herë më të lira në nxjerrjen e informacioneve të tilla personale”, - shprehet Mislav Balunovic, një student doktore në ETH Cyrih dhe një nga autorët e studimit.

Ai shtoi: “Përdoruesit individualë, ose në thelb kushdo që lë gjurmë tekstuale në internet, duhet të jetë më i shqetësuar pasi aktorët keqdashës mund të abuzojnë me modelet për



të nxjerrë informacionin e tyre privat”.

Nga katër modelet e testuara, GPT-4 ishte më i saktë në nxjerrjen e detajeve personale, me 84.6% saktësi, sipas autorëve të studimit. “Llama2” e Metës, “PalM” e Google dhe Claude e Anthropic ishin modelet e tjera të testuara.

Studiuesit zbuluan gjithashtu se “PalM” i Google refuzoi t’i përgjigjej rreth 10% të kërkesave invazive të privatësisë të përdorura në

studim për të nxjerrë informacione personale rreth një përdoruesi, ndërsa modelet e tjera refuzuan edhe më pak kërkesa.

“Nuk është as e qartë se si e rregulloni këtë problem. Ky është shumë, shumë problematik”, - shprehet për “Wired” Martin Vechev, një profesor në ETH Cyrih dhe një nga autorët e studimit.

Për shembull, modeli i studiuesve nxori përfundimin se një përdorues i “Reddit” është nga Melburni sepse ata komentuan për një “hook turn” (kthesë me grip).

Një “hook turn” është një manovër trafiku e përdorur veçanërisht në Melburn, tha GPT-4 pasi u nxit për të identifikuar detaje rreth atij përdoruesi. Kjo nuk është hera e parë që studiuesit kanë identifikuar se si AI mund të përbëjë një kërcënim për privatësinë.

Një studim tjetër, zbuloi se AI-ja mund të deshifrojë tekstin, siç janë fjalëkalimet, bazuar në tingujt e shkrimit tuaj të regjistruar në Zoom, me saktësi deri në 93%.



## Ushtria amerikane do të ndërtojë terrenin e trajnimit të luftës elektronike në Fort Gordon

Një gamë testimi e luftës elektronike është planifikuar për ndërtim në Fort Gordon në Georgia, USA, një zhvillim që zyrtarët e Ushtrisë së SHBA-së thanë se do të forcojë shumë gatishmërinë e trupave.

Planet vijnë pasi shërbimi, më i madhi i ushtrisë, ri-investon në luftën elektronike dhe zotërimin elektromagnetik pas vitesh neglizhencë. Interesi i ri është nxitur nga kërcënimet e paraqitura nga Rusia dhe Kina pas viteve të kaluara në Lindjen e Mesme.

Gjeneralmajor Paul Stanton, oficeri komandues i Fort Gordon, më 11 tetor tha se objektet do të jenë një vend ku ushtarët mund të familjarizohen me pajisjet e tyre të bllokimit dhe ndijimit në mjedise realiste.

“Është një zonë fantastike stërvitore për të shfrytëzuar aftësitë EW”, - u tha Stanton gazetarëve në margjinat e konferencës vjetore të Shoqatës së Ushtrisë së SHBA-së në Uashington. “Është shumë e pyllëzuar, është terren i valëzuar. Ai ka një pistë ajrore të ndërtuar në të, shumë gjëra që do të



përfitojnë nga aftësia jonë për të parë distancat që kanë rëndësi në mjedise manovrimi në shkallë të gjerë, në terren në të cilin ushtria ka të ngjarë të gjejë veten duke luftuar.” Natyra e ndjeshme e EW e ka bërë prej kohësh të ndërlikuar testimin dhe stërvitjen me forcë të plotë. Zyrtarët e mbrojtjes kanë thënë se nuk duan të dëmtojnë fqinjët e këtij spektri dhe nuk duan t’i drejtojnë dorën vëzhguesve të largët, si Moskë dhe Pekini.

Todd Boudreau, zëvendëskomandanti i shkollës kibernetike të Ushtrisë amerikane, në gusht tha se projekti ishte miratuar nga udhëheqja e shërbimit dhe “tashmë” në memorandumim e objektivit të programit, një plan urbanistik i planeve të ardhshme të shpenzimeve.

Gama e jashtme, u tha ai gazetarëve në konferencën AFCEA “TechNet Augusta” në Georgia, do t’u japë studentëve një mundësi për t’u angazhuar me “mjedisin, lëvizjen dhe manovrat, disiplinën e lehtë dhe disiplinën e zhurmës në një mjedis luftarak”.

# KE: Masa për reduktimin e ndotjes mikroplastike nga grimcat plastike

**K**omisioni propozon për herë të parë masa për parandalimin e ndotjes mikroplastike nga çlirimi i paqëllimshëm i grimcave plastike. Aktualisht, nga 52 deri në 184 mijë ton grimca lëshohen në mjedis çdo vit për shkak të keqpërdorimit në të gjithë zinxhirin e furnizimit. Propozimi i sotëm synon të sigurojë që të gjithë operatorët që merren me këtë çështje në BE të marrin masat e nevojshme paraprake. Kjo pritet të zvogëlojë çlirimin e grimcave deri në 74%, duke çuar në ekosisteme më të pastra, duke kontribuar në lumenjtë dhe oqeanet pa plastikë dhe duke reduktuar rreziqet e mundshme për shëndetin e njeriut. Masat e përbashkëta në mbarë BE-në do të ndihmojnë gjithashtu në barazimin e kushteve të lojës për operatorët.

Grimcat e plastikës janë një nga burimet më të mëdha të ndotjes së paqëllimshme mikroplastike. Komisioni sot propozon që operatorët të veprojnë në rendin e mëposhtëm prioritar: parandalimi për të shmangur çdo derdhje të këtyre grimcave; mbajtja e mbetjeve të derdhura për t'u siguruar që ato të mos ndotin mjedisin; dhe, si opsion i fundit, pastroni pas një ngjarje derdhjeje ose humbjeje.

## Propozimi i sotëm përfshin:

Praktikat më të mira të trajtimit për operatorët: në varësi të madhësisë së instalimit ose aktivitetit të transportit, operatorët do të duhet të respektojnë disa praktika më të mira të trajtimit. Këto tashmë janë zbatuar nga kryesuesit.

Certifikimi i detyrueshëm dhe vetëdeklarimet: Për të ndihmuar autoritetet kompetente kombëtare në verifikimin e përputhshmërisë, operatorët më të mëdhenj duhet të marrin një certifikatë të lëshuar nga një palë e tretë e pavarur, ndërsa kompanitë më të vogla duhet të bëjnë vetëdeklarime të konformitetit të tyre.

Një metodologji e harmonizuar për vlerësimin e humbjeve: për të ndihmuar operatorët të monitorojnë humbjet e tyre dhe të trajtojnë disa nga boshllëqet e mbetura të të dhënave, një metodologji e harmonizuar do të zhvillohet nga organet e standardizimit. Ai gjithashtu duhet të rrisë përgjegjshmërinë, duke rritur ndërjegjësimin për ndikimet e praktikave të ndryshme në mjedis dhe shëndetin e njeriut.

Kërkesa më të lehta për SME-të: meqenëse zinxhiri i furnizimit të plastikës ka një pjesë të madhe të SME-ve, kërkesa më të lehta do të zbatohen veçanërisht për operatorët mikro dhe të vegjël.

Propozimi i Komisionit për një Rregullore për parandalimin e tani do të diskutohet nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli. Të gjithë operatorët ekonomikë, si BE dhe jo BE, do të duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e saj.

Komisioni do të vazhdojë të punojë për reduktimin e ndotjes nga mikroplastika, duke përfshirë në kontekstin e zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe të ardhshëm për produktet dhe mbetjet dhe duke udhëhequr përpjekjet globale për t'i dhënë fund ndotjes plastike.

Mikroplastikat janë të qëndrueshme, shumë të lëvizshme dhe të vështira për t'u hequr nga natyra. Ato gjenden në të gjithë botën, madje edhe në vendet më të largëta dhe në trupin e njeriut. Rreziqet që lidhen me nivelet e larta të ekspozimit të njeriut janë një shkak për shqetësim të madh. Grimcat e plastikës gjenden në ujë dhe tokë, duke përfshirë tokat bujqësore, dhe dëmtojnë ekosistemet dhe biodiversitetin. Këto mbetje të plastikës në formën e grimcave rrjedhimisht hahen nga një sërë specimesh detare dhe bregdetare, si breshkat e detit, zogjtë e detit dhe butakët, dhe pasi të gëlltiten, ato mund të shkaktojnë dëm fizik ose vdekje.

Nevoja për të adresuar praninë në rritje të mikroplastikës në mjedis u identifikua në Strategjinë e BE-së për Plastikën, Planin e Veprimt për Ekonominë Rrethore dhe Planin e Veprimt për Ndotje Zero.

Qasja për arritjen e këtij objekti është e trefishtë: të zvogëlojë ndotjen e shkaktuar nga produktet plastike (pasi këto degradohen në mikroplastikë në mjedis); të kufizojë përdorimin e mikroplastikës së shtuar qëllimisht në produkte; dhe të zvogëlojë lëshimet e paqëllimshme të mikroplastikës.



Së bashku me kufizimet për mikroplastikët e shtuar me qëllim të miratuara më 25 shtator 2023, rregullat e miratuara tani janë instrumentet e para të BE-së të krijuara posaçërisht për të trajtuar ndotjen mikroplastike në burim dhe për të kontribuar në objektivin e reduktimit të çlirimeve të mikroplastikës në mjedis me 30% deri në vitin 2030, të vendosura nga Plani i Veprimt për Zero Ndotje.

Komisioni po prezanton gjithashtu një broshurë mbi gjendjen aktuale të ndotjes mikroplastike në BE, duke përmbledhur zhvillimet në politikën, kërkimin, inovacionin dhe investimet e BE-së.

Propozimi i sotëm shënon një hap të rëndësishëm

në luftën kundër ndotjes mikroplastike. Trajtimi i lëshimit të paqëllimshëm të mbetjeve plastike trajton një problem serioz jo vetëm për mjedisin tonë, por edhe për shëndetin tonë dhe na ndihmon të arrijmë ambicien zero të ndotjes të Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane. Kur bëhet fjalë për rrjedhjen e mikroplastikës, parandalimi është zgjidhja e vetme”, - Maroš Šefčovič, Zëvendës-President Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane, Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Parashikueshmërinë.

Çfarë mund të gjendet si në thellësitë e oqeanit ashtu edhe në majën e malit Everest, kryesisht i padukshëm për syrin e njeriut, por i pranishëm në

qarkullimin tonë të gjakut dhe nuk do të zhduket për mijëra vjet? Po, është e drejtë, mikroplastika. Pasi këto grimca të vogla plastike janë në mjedisin tonë, ato janë pothuajse të pamundura për t'u pastruar. Mikroplastika është e përhapur dhe ne duhet të ndalojmë ndotjen në burim. Kjo është arsyeja pse propozimi i sotëm synon të parandalojë derdhjen e mbetjeve plastike në mjedisin tonë, për hir të ekosistemeve dhe shëndetit tonë, dhe në mbështetje të sektorëve ekonomikë që varen nga toka të shëndetshme dhe nga lumenjtë dhe oqeanet e pastër, pa plastikë”, - Virginijus Sinkevicius, Komisioner për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin.

## ● Poliomieli, në prag të zhdukjes njëherë e përgjithmonë

Komisioni Evropian, Banka Evropiane e Investimeve dhe Fondacioni Bill & Melinda Gates njoftuan një partneritet të ri financim për të adresuar mundësitë kritike të shëndetit global: çrrënjësien e poliomielitit dhe sigurimin që risitë në shëndetësi të jenë më të aksesueshme për njerëzit që kanë më shumë nevojë për to. Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNICEF, si partnerë zbatues për financimin e poliomielitit, do të përdorin burimet për të çrrënjësuar poliomielitin, për të mbështetur shpërndarjen e imunizimeve të tjera të fëmijërisë dhe për të forcuar sistemet shëndetësore në mënyrë që ata të jenë më të aftë për t'u përgjigjur kërcënimeve shëndetësore në zhvillim. Paketa e pritshme e financimit prej 1.1 miliardë euro synon të sigurojë fonde të reja për të çrrënjësuar një sëmundje njerëzore vetëm për herë të dytë në histori dhe të ndihmojë në zgjidhjen e sfidave shëndetësore dhe të zhvillimit me të cilat përballesh njerëzit më të cenueshëm në botë, të cilët nuk kanë akses të drejtë në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe risitë.

Presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen tha: “Ne jemi gati të fshijmë poliomielitin nga faqja e Tokës. Komisioni Evropian, EIB dhe Fondacioni



Bill & Melinda Gates po bashkëpunojnë për të kaluar në fazën përfundimtare. Me 1 miliard euro të mbështetur nga strategjia jonë evropiane e investimeve Global Gateway, ne do të investojmë në sisteme më të forta shëndetësore globalisht dhe në prodhimin dhe administrimin lokal të vaksinave dhe ilaçeve, aty ku është më e nevojshme. Bashkëpunimi global na ka ndihmuar t'i japim fund pandemisë COVID-19. Tani do të na ndihmojë të heqim qafe poliomielitin njëherë e përgjithmonë.”

“Sot ne jemi të bashkuar për të shkruar kapitullin e fundit në historinë e poliomielitit. Banka Evropiane e Investimeve po luan rolin e saj në një partneritet unik me partnerë filantropikë dhe shëndetësorë, duke ofruar 500 milionë euro për investime në mbështetje të Programit

Global për Çrrënjësien e Poliomielitit. Kjo nismë do të jetë një moment historik në rritjen e imunizimit dhe forcimin e kujdesit shëndetësor, duke siguruar që çdo fëmijë, pavarësisht nga rrethanat e tij, të mund të mbrohet nga poliomieli”, tha Werner Hoyer, President i Bankës Evropiane të Investimeve.

Fondet do të mbulojnë vaksinat e poliomielitit për gati 370 milionë fëmijë në vit; do të ofrojë shërbime jetike shëndetësore për fëmijët së bashku me fushatat e poliomielitit, duke përfshirë vaksinat e frutit dhe imunizimet e tjera rutinë; dhe për të forcuar sistemet shëndetësore për t'u përgatitur dhe për t'u përgjigjur më mirë kërcënimeve shëndetësore, siç ka bërë programi i poliomielitit kundër COVID-19, Ebolës dhe sëmundjeve të tjera. Sot, poliomieli i egër mbetet endemik në vetëm dy vende - Pakistan dhe Afganistan - dhe 80% e rasteve të ndryshme të virusit gjenden në vetëm katër rajone nënkombëtare. “Unë jam i përkushtuar të siguroj që asnjë fëmijë, kudo në botë, të mos përballet me këtë sëmundje të tmerrshme. Unë jam gjithashtu optimist se ne do ta zhdukim poliomielitin një herë e mirë dhe do t'i bëjmë risitë shëndetësore më të aksesueshme për të gjithë, veçanërisht ato në vendet më të varfra”, - tha Bill Gates, bashkëkryetar i Fondacionit Bill & Melinda Gates.

## IN MEMORIAM

**H**alil Qendro është një nga poetët ushtarakë me krijimtari të pasur letrare, si në prozë ashtu edhe në poezi, njëkohësisht edhe publicist i njohur. Ai është ndër krijuesit që kanë studiuar në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, por që fatkeqësisht, në jetë vuajti jo pak, duke provuar dhe heqjen e të drejtës për të publikuar krijimtarinë dhe internimin.


Halili lindi në Progonat në vitin 1936, ku mbaroi dhe vitet e para të shkollës. Në vitin 1949 nisi studimet në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, të cilat i përfundoi me rezultate shumë të mira. Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe, ai shfaqti talentin për poezinë dhe arriti të botojë poezi në shtypin e kohës, veçanërisht në shtypin ushtarak. Më vonë, Halili u diplomua pranë Universitetit të Tiranës, dega Gjuhë-Letërsi, duke iu kushtuar tashmë ëndrrës së tij për artin plotësisht. Ai ka punuar gazetar dhe redaktor në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri” në Tiranë, ku manifestoi profesionalizëm. Por për qëndrimet e tij kritike ndaj skemës së Realizmit Socialist u internua për 22 vjet, duke iu hequr edhe e drejta e botimit. Ka botuar në poezi e prozë. Botime në poezi: “Dashuri e shqetësuar”, “Këngët e Progonatit”, “Loti i diellit”, “Hemorragji”, “Endacaku i shpresës”, “Jam tepër i lodhur”, “Ezopi në gjyq”.

Botimet në prozë: “Si në balada” (tregime e novela), “Rrëfimet e pasmesnatës” (tregime e novela), “Pasqyrë pas shpine” (roman), “Dimra të Shqipërisë në dy kohë” (roman).

Ai ishte dhe veprimtar i palodhur shoqëror. Halili qe kryetar i parë i Shoqatës Kulturore Atdhetare “Labëria” zgjedhur nga Kuvendi i Parë i saj, në qershor të vitit 1998.

Është ndarë nga jeta më 23 shtator 2013, pas një sëmundjeje të rëndë.

# Skënderbegas të shquar në fushën e artit




**Halil Qendro, publicisti,  
poeti dhe shkrimtari i njohur**



HALILI LINDI NË  
PROGONAT NË  
VITIN 1936, KU  
MBAROI DHE  
VITET E PARA  
TË SHKOLLËS.  
NË VITIN 1949  
NISI STUDIMET  
NË SHKOLLËN E  
MESME USHTARAKE  
“SKËNDERBEJ”, TË  
CILAT I PËRFUNDOI  
ME REZULTATE  
SHUMË TË MIRA.

## IN MEMORIAM

**F**adil Zeqiri, shkrimtar i njohur, është një nga nxënësit e Shkollës Ushtarake “Skënderbej” që pati një karrierë të suksesshme si ushtarak, por dhe si publicist. Fadil Zeqiri u lind në Kajcanj të Paramithisë së Çamërisë, më 15.07.1937. Shovinistët grekë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, i vranë prindërit dhe shumë të afërm të tij. Mbeti jetim dhe kështu detyrohet të vijë në Shqipëri. U strehua në Sarandë, në jetimore. Katër ditë udhëtoi për në Durrës e pastaj shkoi në Tiranë, ku dhe u rrit e u edukua në Shtëpinë e Fëmijës. Kreu Shkollën e Mesme “Skënderbej” dhe më pas, në Bashkimin Sovjetik, studioi për Marinë Detare. Pesë vjet i bëri atje, nga të cilat tre në Riga të Letonisë dhe dy në Azerbajxhan për Artilerinë Bregdetare dhe Marinë të Përgjithshme. Emri i tij ka qenë nderi i Sazanit, Karaburunit, Orikumit, Vlorës e Babicës, ku shërbeu me përkushtim e devotshmëri në funksion të forcave detare shqiptare. Pa u shpëputur nga puna studioi për letërsi si dhe thelloi studimet, duke përfunduar dhe Fakultetin Juridik. Për shumë vite ka qenë pedagog në Shkollën e Lartë të Marinës në Vlorë. Ishte kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Shoqatës “Çamëria”, anëtar i kryesisë së Shoqatës Atdhetare-Kulturore Mbarëkombëtare “Ismail Qemali”, ku ka qenë i ndjeshëm qëndrimi i tij kombëtar, në shërbim të rritjes së ndjenjës së atdhedashurisë dhe



**Fadil Zeqiri,  
shkrimtar i njohur**

respektimit deri në adhurim të simboleve të ndritura kombëtare si Pirro i Epirit, Gjergj Kastrioti, Hasan Tahsimi, Elena Gjika, vëllezërit Frashëri, Ismail Qemali, Isa Boletini e gjithë ata pishtarë dritëbërës, për të orientuar shqiptarët në rrugën e diturisë, e lirisë, mirësisë e vëllazërisë, se vetëm ajo na sjell përparim. Fadil Zeqiri ka qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë qysh nga viti 1965. Ai ka debutuar kryesisht në prozë, por ka shkruar dhe poezi, skenarë filmash, ekranizuar a botuar sidomos për interesa të ushtrisë, në radhët e së cilës kaloi tërë jetën, qysh nga fëmijëria e derisa mbushi moshën e doli në pension. Në prozë ka nxjerrë në dritë nga shtëpia botuese “Naim Frashëri” librat: “Midis dallgëve të oqeanit”, “Me vështrim nga deti” - tregime, “Shtegëtimi i fundit” - roman, “Nëndetësja 61” - roman, “Dhembti i tretë” - tregime, “Udhëtim në një hambar” - tregime, “Shënjestra dhe manushaqja” - tregime, monografinë “Ilia Dashi”, kushtuar heroit nga Poro e Myzeqesë së Vlorës. U nda nga jeta më 2 gusht 2008.

Marrë nga kolana  
“Skënderbegasit ndër vite”



# Shqipëria, 65 vite pjesë e UNESCO-s

**D**rejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) në cilësinë e institucionit të administrimit, të mirëmbajtjes dhe të vënies në shfrytëzim të trashëgimisë dokumentare të kombit, zotëron dy dorëshkrimet e mirënjohura, Beratinus 1 dhe 2, të cilët u bënë pjesë e Regjistrit të Kujtesës së Botës në vitin 2005.

Kodiku i Purpurt i Beratit, daton në shekullin VI dhe është i shkruar në pergamenë të purpurt. Ndërsa, Kodiku i Artë (Codex Aureus) i përket shekullit IX dhe është i shkruar në pergamenë me shkronja ari. Gjashtë pasuritë e tjera shqiptare që janë pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s janë: Liqeni i Ohrit, Lumi i Gashit, Rrajca, Berati, Butrinti dhe Gjirokastra. UNESCO-ja mbledh rreth vetes 193 vende anëtare.

## Liqeni i Ohrit edhe Liqeni i Pogradecit

Liqeni i Ohrit edhe Liqeni i Pogradecit (Ohridsko Ezero) është një nga liqenet më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe llogaritet si një nga liqenet më të vjetra në botë.

Ai gjendet në një lartësi prej 695 metrash dhe ka një sipërfaqe prej 349 km<sup>2</sup>. Pika më e thellë e liqenit është 289 metra. Pjesa më e madhe e liqenit i përket Maqedonisë së Veriut, kurse pjesa tjetër i përket Shqipërisë.

Në bregun e liqenit shtrihen tre qytete të mëdha: Ohri dhe Struga në Maqedoni.

Liqeni i Ohrit llogaritet si një nga liqenet më të vjetra në mbarë botën. Moshë e tij llogaritet të jetë 2 deri më 5 milion vjet. Liqeni u krijua nga një shembje e tokës. Këtë e vërtetojnë aktivitetet e shumta tektonike si dhe ekzistenca e një mali prej 100 metrash në nivelin e liqenit. Liqeni i Ohrit është një nga tërheqjet e shumta për turistë vendas dhe të huaj.

Besohet se në rastin e Liqenit të Ohrit ky proces u vonua nga thellësia e saj e madhe dhe nga kontributi i vogël i sedimenteve nga hyrjet e filtruara të pranverës.

Në dallim nga Liqeni i Ohrit, Liqeni i Prespës ka të ngjarë të jetë kthyer disa herë në historinë e tij, si rezultat i nëntokës karstike.

## Flora dhe fauna

Liqeni i Ohrit është shtëpia e shumë kafshëve endemike, të cilat vijnë vetëm në ujërat e tij. Në liqen rriten 40 specie të rralla, ndër më të njohurat dhe ekonomiksht më të rëndësishmet është peshku i pastër i llojit *Salmo letnica* (korani), "*Salmothimus ohridanus*" (belushka).



Liqeni i Ohrit edhe Liqeni i Pogradecit

Një pjesë e Bregut të liqenit së bashku me qytetin e Ohrit është emëruar nga UNESCO si trashëgimi botërore.

## Lumi i Gashit

Lumi i Gashit, shpallur si zonë e mbrojtur "Rezervë Strikte Natyrore" në vitin 1996 dhe prej vitit 2017 pjesë e rrjetit të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, konsiderohet një mrekulli natyrore.

Me një sipërfaqe prej 3 mijë hektarë, Lumi i Gashit shtrihet në pjesën lindore të Alpeve Shqiptare duke u kufizuar në veri me Malin e Zi dhe në veri-lindje me Kosovën.

Për të vizituar këtë mrekulli natyrore në pellgun e parkut kombëtar të Valbonës në Tropojë, duhet ndjekur rruga automobilistike nga Bajram Curri në fshatrat Dragobi, Qerem, Markovce, Rorkuz dhe Doberdol, ndërsa nga këtu ndiqet rruga këmbësore drejt Lumit të Gashit, rrugë e cila zgjat 45 minuta. Gjithashtu një tjetër shteg në rrugë këmbësore që të çon në Lumin e Gashit është Tropoja e vjetër, duke kaluar përmes zonave, Degaj, Kanali i Gashit, Brodoshnicë, Qafa e Livadhit, Kusheticë dhe Doberdol.

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së Lumit të Gashit është thujse tërësisht e mbuluar me pyje të virgjëra ahu dhe pjesa tjetër me pyje halorë si *Pinus heldreichii*, *Abies Alba*, *Pinus sylvestris*, *Pinus peuce*. Rrjedha e pandalshme e shumëvjeçare e ujit të këtij lumi e ka ndihmuar botën e gjallë të lulëzojë dhe të marrë jetë nga ai. Llojet më të përhapura ndër to janë *Ranunculus platanifolius*, *Cardamine enneaphyllos*, *Actaea spicata*, *Geum coccineum*, *Cephalantera rubra*, *Digitalis grandiflora*, *Viola aethiologica*, *Viola tricolor*. Përveç kësaj, këtu gjenden edhe specie bimore të listuara në librin e kuq që ia rrisin vlerat zonës si; *Atropa Belladonna*, *Lilium albanicum*, *Convallaria majalis* dhe *Lunaria telekiana*, kjo e fundit bimë endemike. *L. telekiana* është një specie shumë e rrallë dhe e rrezikuar, e cila rrit vlerat e biodiversitetit në pjesën e Lumit të Gashit.

Për sa i përket faunës kjo zonë krijon kushte shumë të favorshme për rritjen dhe përhapjen e shumë llojeve të kafshëve dhe shpendëve.

Llojet kryesore të kafshëve që gjenden në këtë zonë të rrallë natyrore janë, ariu i murrme (*Arsus arctos*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), macja e egër (*Felis silvestris*), ujku (*Canis lupus*), derri i egër, lepuri, dhelpra. Kurse shpendë, mund të përmendim: gjeli i egër (*Tetra urogallus*), shqipja e Ballkanit (*Circus pygargus*), shkaba (*Gyps fulvus*), thëllëza e malit, (*Alectoris graeca*) etj.



Lumi i Gashit



Rrajca

### Rrajca

Rrajca ka 2129.5 ha zona strikte, 2509.85 zona buferike. Më 7 korrik 2017, në sesionin e 41-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, i mbledhur në Krakov, Poloni, u miratua zgjerimi i zonës së Trashëgimisë Botërore të pyjeve të vjetër të Ahut (*Fagus sylvatica*, L.) edhe me dy zona nga Shqipëria, duke i përfshirë ato në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Ky zgjerim ndërkuftar i siteve të Trashëgimisë Botërore të pyjeve primar të Ahut të Karpateve dhe pyjeve të Ahut të Gjermanisë (Gjermania, Sllovakia, Ukraina) shtrihet në 12 vende. Që nga fundi i epokës së fundit të akullnajave, ahu evropian u përhap nga disa strehime të izoluara në Alpe, Karpate, Mesdhe dhe Pirenej, për një periudhë të shkurtër prej disa mijë vitesh në një proces që është ende në vazhdim.

Ky zgjerim i suksesshëm lidhet me fleksibilitetin e llojit dhe tolerancën e kushteve të ndryshme klimatike, gjeografike dhe fizike.

Pyjet primare të Ahut të Karpateve dhe në rajonet e tjera të Evropës (Shqipëri, Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Gjermani, Itali, Rumani, Sllovakia, Slloveni, Spanjë, Ukrainë), përfshihen në Listën e Trashëgimisë Botërore, të UNESCO-s.

Rrajca, një fshat në lartësitë e Librazhdit, pjesë e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, po kthehet çdo vit e më tepër një atraksion i fuqishëm turistik. Brenda parkut gjenden mbi 14 liqene akullnajore të vogla me bukuri madhështore, të cilat ndodhen në një lartësi mbi 1900 metra mbi nivelin e detit.

Janë Liqenet akullnajore të Rrajcës, pjesë e këtij Parkut, që e bëjnë Rrajcën një nga destinacionet e veçanta turistike natyrore që mund të eksplorojnë në çdo stinë.

### Berat

“Qyteti i një mbi një dritareve” mendohet që të jetë themeluar që në epokën e bronzit, por që formën e tij të mirëfilltë e mori si qytet-kështjellë, i quajtur Antipatrea, në vitet 313-310 para lindjes së Krishtit. Pikërisht ky ka qenë edhe emri i tij i parë zyrtar me të cilin njihet edhe nëpërmjet dokumenteve. Ai gjithashtu për nga rëndësia e tij, që kishte gjatë pushtimit romak në shekullin II para Krishtit, u emërtua edhe si “Fortesa e Arbërve”.

Në vitin 1961, Berati u shpall zyrtarisht qytet-muze, me pasuri të konsiderueshme monumentesh dhe me vlera të larmishme, të cilat përbëjnë një dëshmi të trashëgimisë kulturore, historike e artistike, të jetës e të punës, të realizuara mjeshtërisht brez pas brezi nga banorët e tij. Nga zonifikimi dhe nga përcaktimi i kategorisë së monumenteve qyteti ndahet në tri zona: zona muze, zona e mbrojtur dhe zona e lirë.

Sot Berati trashëgon 210 objekte muzeale, nga të cilat 150 janë objekte në këmbë. Prej tyre, 60 janë monumente të kategorisë së parë dhe të tjerat të kategorisë së dytë.

Kështjella ose kalaja, siç quhet nga beratasit është ndërtuar mbi kodrën shkëmbore në formë trekëndëshi. Ura e Goricës është një nga monumentet e kulturës dhe të arkitekturës së Beratit dhe njëkohësisht një nga simbolet e tij. Ajo është ndërtuar në vitin 1780 për t’u rindërtuar më vonë në formën që ka sot. Aty ndodhen shumë kisha të periudhës bizantine si dhe vend për artin dhe zejet e këtij qyteti. Arkitektura e rrallë e këtij qyteti afro 2500-vjeçar, trashëgimia që mbart e bëjnë këtë qytet vërtetë të rrallë.

### Butrinti

Në vitin 1992, Butrinti u pranua si vendbanimi i parë arkeologjik



Butrinti

i Republikës së Shqipërisë në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Parku kombëtar i Butrintit është një nga zonat më të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore, arkeologjike, mjedisore dhe turistike të vendit. Zemra e parkut kombëtar është qyteti antik i Butrintit, ekzistenca e të cilit vazhdoi pa ndërprerje, që prej periudhës së prehistorisë e deri në mesjetë, duke ofruar kështu një shumëllojshmëri kulturash dhe periudhash historike. Në saje të vlerave të larta historiko-kulturore, qyteti antik i Butrintit u përzgjedh fillimisht si monument kulture në vitin 1948, në ligjin e monumenteve të kulturës së Shqipërisë. Brenda parkut ndodhen 10 zona të shquara arkeologjike që lidhen me historinë e Butrintit. Disa prej tyre janë zona brenda mureve të Butrintit, ajo jashtë mureve, Diapori, Fortesa - kalaja e Ali Pashë Tepelenës, Kalivoi, Shën Dëllia, Shën Dhimitri, Xarra, Ana e Kanalit të Vivarit etj. Krijimi i parkut kombëtar u bë një domosdoshmëri, sipas specialistëve, për ruajtjen e vendndodhjes dhe atmosferës unike të Butrintit, për ruajtjen e të dhënave arkeologjike të disa qendrave dhe monumenteve të zbuluara në këtë vatër të qytetërimit antik.

### Gjirokastra

Qytet i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s më 2005, si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan të qyteteve tregtare të stilit osman.

Arkitektura e ndërtesave historike në Gjirokastrë, si dhe vetë qyteti i vjetër, është produkt i shumë përbërësve. Relievi i thyer ka lënë vulën në përcaktimin e vendosjes dhe mënyrën e shtrirjes së qytetit, që u krijua dhe u rrit nëpër kurrizet e kodrave, nën hijen e kalasë. Nga ana tjetër, afërsia e burimeve, prej ku sigurohej guri i nevojshëm për muret dhe për çatitë, mundësoi pamjen e veçantë që ka qyteti.

Gjirokastra ishte një qendër e rëndësishme administrative e shekullit XIX, e populluar nga pronarë tokash që kishin të ardhura ekonomike sa të ndërtonin shtëpi-kulla madhështore të fortifikuara. Qyteti ka mbi 500 ndërtesa historike. Veçoritë e jetës së kohës në Shqipëri lanë gjithashtu gjurmë në arkitekturën e tyre: nevojiteshin strukturat mbrojtëse, sepse shqiptarët herë pas here luftonin kundër njeri-tjetrit; për më tepër ata rebeloheshin kundra Portës së Lartë në Stamboll.

Duhej një vend i sigurt edhe për bagëtinë në dimër; duhej dhe vendi për të rezervuar ujin për gjatë muajve të thatë të verës. Katet përdhese të kullave ishin edhe struktura mbrojtëse edhe magazina të shtëpisë. Ndërsa katet e sipërme shprehnin mikpritjen gjirokastrite,

kulturën dhe mënyrën e jetesës së tyre; por, përmes interierëve të pasur, edhe rangun e pasurinë e të zotëve të shtëpisë. Herë-herë kjo e fundit duket sikur tejkalon dukshëm edhe vetë funksionin mbrojtës të shtëpisë. Për t’u nënvizuar është për qendrën historike të Gjirokastrës edhe prezenca e ndërtimeve të stilit italian, të ndërtuar në fillim shekullin e kaluar. Objektet e stilit italian përfaqësojnë elementët e parë evropian të zhvillimit në qytet: Hotelet “Royal” dhe “Savoia”, “Banka Nazionale d’Albania” dhe “Banka di Napoli”, Kompleksi tregtar “Zigai”, “Vila Kokalari” dhe “Papavangjeli”, Gjimnazi, etj.



Berat



Gjirokastra



# 12 TË DREJTA STUDIMI

**NË AKADEMITË  
USHTARAKE MË  
TË MIRA NË SHBA**

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 12 (dymbëdhjetë) të drejta studimi si më poshtë vijon:

AKADEMI A USHT ARAKE DETARE, 6 (GJ ASHTË) K UOTA.

AKADEMI A USHT ARAKE "WEST POINT", 6 (GJ ASHTË) K UOTA.

AFATI KOHOR PËR DORËZIMIN E DOK UMENTACIONIT PRANË QENDRËS SË PERSONEL REKR UTIMIT ËSHTË DERI MË  
27 TETOR 2023.

<https://www.mod.gov.al/newsroom-2/njofitim/6063-qendra-e-personel-rekrutimit-do-te-rekrutoje-kandidate-per-studime-ne-akademitë-ushtarake-te-shteteve-te-bashkuara-te-amerikes-12-dymbedhete-te-drejta-studimi>

TEL: 042 348 588